



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1047/1 Prot.

Tiranë, më 02. 08. 2018

V E N D I M

Nr. 157, Datë 02. 08. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 109, datë 24.07.2018, e shtetasit R. M., kundër mediave vizive: News 24, Top Channel, Tv Klan, Ora News, Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) etj, me pretendim diskriminimin *për shkak të bindjeve politike, fetare, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër.*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

R. M. sqaron se, referuar gjendjes së rënduar ekonomike, nëpërmjet telefonatave, mesazheve apo shkresave, i është drejtuar disa herë për ndihmë Televizionit Publik Shqiptar - RTSH dhe televizioneve private si: News 24, Top Channel, Tv Klan, Ora News, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Pas kontakteve me këto subjekte, i është thënë se do ta telefonojnë sërish, por nuk ka marrë asnjë telefonatë prej tyre. Gjithashtu, subjekti ankues pretendon se ka patur raste kur mediat e sipërcituara nuk i janë përgjigjur telefonatave të tij.

I ndodhur në këtë situatë, ankuesi pretendon se është përjashtuar dhe trajtuar në mënyrë diskriminuese nga mediat vizive të sipërcituara, për shkak të bindjeve politike, fetare, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër.

Përsa me lart, ankuesi nuk kërkon konstatimin e diskriminimit nga Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por t'i gjendet një mundësi dialogimi, këshillimi apo ballafaqimi me individ apo organizata të shoqërisë civile të cilët ta mbështesin ekonomikisht.

Me anë të shkresës¹ datë 15.05.2018, paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, R. M. ka informuar Komisionerin se për shkak të bindjeve të tij fetare, nuk ka pranuar të pajset me dokument identifikimi elektronik (pasaportë apo kartë identiteti) dhe kartë shëndeti. Për këtë arsye, në momentin që ka paraqitur ankesën, nuk ka depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi letërnjoftimin për identifikimin e tij.

Në nenin 33, pika 4/a, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet nëse është anonime”. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se ankuesi nuk ka paraqitur dokumentin e identifikimit për të vërtetuar identitetin e tij përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por ka paraqitur dokumentin e identifikimit të nënës, P. M.

Në nenin 4, pika b, ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se: “Ankesa nuk pranohet nëse përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”

Përsa i përket kërkesës së sipërcituar në ankesë nga R. M., Komisioneri sqaron se këto janë masa të cilat nuk bëjnë pjesë në fushën e veprimit dhe kompetencat e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këto kushte ankesa e R. M. nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të shqyrtimit të ankesës pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërmat a) dhe b) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 109, datë 24.07.2018, të R. M., pasi ankesa e tij është e papajtueshme me dispozitat dhe nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

¹ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 667 prot., datë 16.05.2018

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike, fetare, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)